



Prishtinë, 21 shtator 2020

## KOMUNIKATË

### **ZRRE dhe AKK përmes nënshkrimit të Marrëveshjes formalizojnë bashkëpunimin dhe koordinimin për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë**

Sot me 21 shtator 2020, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK), kanë nënshkruar Marrëveshje mirëkuptimi përmes të cilës kanë shprehur interesin e përbashkët për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve në fushën e tregut të energjisë në Republikën e Kosovës.

Përmes kësaj Marrëveshje janë krijuar mekanizmat e bashkëpunimit ligjor dhe institucional për të vepruar në parandalimin dhe eliminimin e ç'do sjellje, të ndërmarrjeve dhe ndërmarrësve, e cila mund të ndikojnë negativisht në paraqitjen e konkurrencës në tregun e energjisë në Republikën e Kosovës.

Ushtruesi i detyrës së Kryesuesit të Bordit të ZRRE, Z. Arsim Janova, me këtë rast ka theksuar se "nënshkrimi i kësaj Marrëveshje është vetëm formalizim i një bashkëpunimi të dy institucioneve, që ka ekzistuar edhe deri më tani, duke u bazuar në kërkesat ligjore për shkëmbim të informatave me qëllim të funksionimit të duhur të tregut të energjisë". Përderisa kryetari i Bordit të AKK duke e cilësuar sektorin e energjisë si fushë të rëndësishme për AKK ka theksuar se "Marrëveshja që nënshkruam sot është më shumë se shprehje e vullnetit për të nxitur bashkëpunim afatgjatë në mes të dy institucioneve".

Kjo Marrëveshje është hartuar me qëllim të koordinimit të aktiviteteve ndërmjet dy autoriteteve, ZRRE dhe AKK, duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 61 të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e Konkurrencës, Nenit 16 paparagrafit 1, pikat 1.9 dhe 1.11 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, paragrafit 4 të Nenit 24 të Ligjit nr. 05/L081 për Energjinë.